

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGJENCIA PROTIV KORUPCIFE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DP&DMP	Nr. Prot.	03-2700/13
Dep.		Br. Prot.	
Nr. I faq.		Prot No.	
Broj stranica	02	Data	06.09.2013
Nr. pages		Datum	
		Date	

Nr. Regj. 32184/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, gjyqtaria Azra Cakolli me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Feti(Lazam)Mehdiu, nga Matiqani Komuna e Prishtinës, për kundërvajtje nga neni 5, 6 par 1.3 dhe neni 9 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe neni 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet(LK) GZ KSAK 23/79, më datë 03.09.2013 morri këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Feti(Lazam)Mehdiu, i lindur më 20.01.1944 në fshatin Zajazë, Komuna e Kerqovës, tani me vendbanim në rrugën "Isa Kastratit", pn, në Matiqan, Këshilltar Komunal në Prishtinë, i martuar baba i katër fëmijëve, ka kryer fakultetin Filozofikë, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse si zyrtarë i lartë publik në pozitën e Këshilltarit Komunal në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë sipas Kërkesës së Agjencisë të bërë në vitin 2012, dhe atë afati për deklarin sipas kërkesës së Agjencisë ka qenë prej 01.03.2012 deri më 31.03.2013, -
- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5, 6 par 1.3 dhe neni 9 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, andaj i shqiptohet,

D Ë N I M I

Më gjobë në shumë prej 450(katërqindpesëdhjetë)€, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjë agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **22 ditësh**, duke iu llogaritur nga **20 €**, për një 1 ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është e obliguar të paguaj shumën prej **5.€**, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje e këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate kërkesën Nr. 01-2502/2012 me datë 07.08.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit, për kundërvajtje nga neni 5, 6 par 1.3 dhe neni 9 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, me të cilën kërkesë i vihet në barrë se në Agjencinë Kundër Korrupsion nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë.

Më datë 22.10.2012 gjyqtaria ka marr aktvendim me të cilin Feti Mediu është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 450 €. Kundër këtij aktvendimi kanë ushtruar ankesë i pandehuri Feti Mediu si dhe Agjencisë Kundër Korrupsion. Gjykata e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë me Aktvendimin GJL nr. 1279/12 të datës 13.11. 2012 ka abroguar

procedurës dhe rivendosje. Duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së lartë, gjyqtaria mori në pyetje përsëri të pandehurin Feti Mediun i cili deklaroi se në lidhje mos deklarimin e pasurisë në kërkesë të Agjencionit, ftesa për tu lajmëruar në Agjenci i ka ardhur më 6. gusht 2012 dhe se në atë kohë zyrtari kompetent ka qenë në pushim vjetorë dhe për këtë arsye nuk ka pas mundësi të informohet për çka bëhet fjalë dhe se deri më datën 22.08.2012 nuk ka mundur me kontaktuar me zyrtarin e Agjencisë, në ç rast dhe ka bërë plotësimin e formularit për deklarim të pasurisë të cilin deklarim e ka bërë me vonesë duke pretenduar se pa fajin e tij ka ardhur deri te vonesa. Ka prezantuar Vërtetimin nr. 03/3643/12 të datës 22.08.2012 për deklarim të pasurisë.

Është ftuar pika kontaktuese Nexhmije Krasniqi, e cila deklaroi se Feti Medihu është njoftuar si të gjithë Këshilltarët të tjerë dhe gjykatës ia ka prezantuar Listën për Dorëzimin e Formularëve të datës 22.03.2012, ku shihet nënshkrimi që ka pranuar formularin në fjalë, deklaratën e ka dhënë në prezencën e Fetiut dhe i njëjti e ka parë nënshkrimin e tij në Listë.

Poashtu u dëgjua dhe Përfaqësuesi i agjencisë Enis Sadiku i cili deklaroi se me Ligjin e mëhershëm nr. 03/L-151 nuk ka qenë e paraparë pozita e Këshilltarit Komunal si zyrtarë i lartë publik dhe se sipas Ligjit të Ri nr. 04 /L-050 edhe Këshilltarët Komunal si zyrtarë të lartë kanë pas për obligim ta deklaron pasurinë dhe pika kontaktuese Nexhmije Krasniqi më datë 16.02.2012 na ka dhënë Listën e zyrtarëve të lartë publik në Komunën e Prishtinës dhe në atë Listë qëndron emri i Feti Mehdiut. I njëjti ka pas për obligim deklarimin e pasurisë sipas kërkesës së Agjencionit me e bërë në afatin prej 01.03.2012 deri më 31.03.2012 i cili afat është përputh me formularët e dërguar personave të tjerë zyrtar të lartë në Komunën e Prishtinës, të cilët kanë bërë deklarimin e rregullt vjetorë. Nuk është e vërtet se ne i kemi dërguar ftesë më datë 06. gusht 2012 por me një shkresë e kemi lajmëruar z. Hmitin, Kryesuesin e Kuvendit Komunal se është iniciuar procedura kundërvajtëse kundër Këshilltarit Komunal Feti Mehdiu, ashtu si që e parasheh ligji, poashtu në Agjencion në çdo kohë ka persona të cilët i pranojnë formularët, andaj nuk është e vërtet se nuk ka pas mundësi të dorëzimit për shkak se personeli ka qenë në pushim vjetor, pasi që më 31 mar personeli ka punuar dhe nuk kanë qenë në pushim vjetor. Konsideroj se i njëjti i ikë përgjegjësishë në këtë mënyrë dhe se e ka kryer kundërvajtjen.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimin të deklaratës së të pandehurit, dëgjimi i Përfaqësuesit të agjencisë Enis Sadiku, dëgjimi i pikës kontaktuese Nexhmije Krasniqi, në cilësi të dëshmitares e cila e ka prezantuar listën për dorëzimin e Formularëve të datë 22.03.2012 ku shihet se Feti Mehdiu ka nënshkruar se i është dorëzuar Formulari, këtë edhe në seancë në prezencë të Fetut e njëjta e ka deklaruar, si dhe në bazë të vlerësimin të shkresave të tjera të lëndës e posaçërisht nga administrimi i provës materiale të prezantuar si që është Vërtetimin nr. 03/3643/12 të datës 22.08.2012. se ka bërë deklarimin me vonesë, gjyqtaria në mënyrë bindëse vërtetoi se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, për çka e shpalli përgjegjës dhe e dënoj me gjobë duke aplikuar nenin 9 në ç rast i shqiptoi dënim nën minimumin e paraparë me ligj ashtu si është cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke pas parasysh moshën e tij si dhe të ardhurat të cilat i përfiton nga Komuna si këshilltar, duke konstatuar se i njëjti në çdo mënyrë tenton ti iki përgjegjësishë kundërvajtëse duke i fajësuar të tjerët për lëshimet e tija.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, nën të cilat është kryer kundërvajtja, peshën e veprës së kryer, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësishë, andaj i shqiptoj dënimin me gjobë nën minimumin e paraparë, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme. Me sa u tha u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDORËS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Rëgj. 22134/2012 datë 22.10.2012



KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Apelit-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.